



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

## KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

### Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 001/060 – 50230

Më: 22 prill 2024

Nga mbledhja e jashtëzakonshme e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 22 prill 2024, në Sallën e mbledhjeve të KPF-së, në “Shtëpinë e Bardhë”, me fillim në ora 10:15 minuta.

**Pjesëmarrës nga KPF-ja, ish-in:** Antigona Bytyqi, Kryesuese e KPF-së, Karanfil Haxhillari, Dafina Alishani, Adem Shabanaj, Egzona Hoxhaj, Naxhije Memaj, Levent Buş dhe Bajram Kastrati, të gjithë anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

**Mungoi:** Florent Ukaj.

**Pjesëmarrës tjerë ish-in:** Kujtim Gashi, Nënkyetar i Komunës, Sulltan Badalli, Drejtor i DEF, si dhe OJQ-të e Mediat.

**Antigona Bytyqi:** Përshëndetje të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, i nderuar Nënkyetar, i nderuar drejtor, media përshëndetje për të gjithë ju të pranishëm. Ashtu edhe suç jeni të njoftuar me kohë, ne e kemi thirrë me kërkesë të kryetarit një seancë të jashtëzakonshme dhe rrjedhimisht është dashtë me thirrë edhe mbledhjen e KPF-së meqë ka të bëjë me bartjen e mjeteve. Rendi i ditës është me një pikë të vetme:

1. Bartja a mjeteve nga të hyrat vetanake të rritura nga ato të planifikuara të vitit 2023 në vitin 2024.

**Antigona Bytyqi:** Pra, kjo është pika e vetme e rendit të ditës. Po ja kalojmë fjalën drejtorit.

**Sulltan Badalli:** Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë. Këtë vit është një ndryshim me krahasu me vitet tjera tek bartja e mjeteve. Tek bartja e mjeteve të pashfrytëzuara, ministria do t'i bartë në mënyrë automatike do të thotë mjetet e pashfrytëzuara. Po, kemi të bëjmë tash me mjetet që janë tejkualuar nga planifikimi, është një vlerë prej 2 milion e 487 mijë edhe e kemi pasur një procedurë pak si të gjatë me ministrinë, takime të vazhdueshme kemi pasur. realisht plani u kanë që në muajin e tretë me i futë me një mbledhje që është mbajtë, mirëpo për shkak të procedurave me ministrinë që i kemi pasë për bartjen e tyre nëpër projekte të ndryshme është zgjatur. Kemi pasur disa takime me ta, por përfundimin e kemi pru që në rregull është dhe e kemi parë të arsyeshme me i pru në kuvend edhe me i votu që sa më shpejtë, për shkak se është e

nevojshme për me i shfrytëzu, me i shpenzu për projektet të cilat janë në vazhdimësi. Kjo është procedurë e rregullt si çdo vit normal. Ju faleminderit.

**Antigona Bytyqi:** Faleminderit drejtor. Dikush prej anëtarëve në qoftëse dëshironi me marrë fjalën? Po urdhëro Karanfil.

**Karanfil Haxhillari:** Përshëndetje për të gjithë. Është thirrë një mbledhje e jashtëzakonshme për bartje të mjeteve nga të hyrat vetanake e cila po konsideroj që nuk ka afate ligjore që duhet me urgjencë të trajtohet kjo pikë. duke e pasur parasysh që neve në javën e ardhshme e kemi seancën e rregullt. Tash këtu dy gjëra janë në pikëpyetje! E para ndoshta kryetari nuk e ka ditur që do të kemi seancë me të 30-tin dhe e ka thirrur këtë mbledhje të jashtëzakonshme. Por me të vërtetë a e din, unë kisha propozu që pse mos të jetë në seancë të rregullt, pra kjo pikë të bartet në seancën e rregullt edhe ashtu kemi pika të cilat nuk na marrin shumë kohë në seancën e rregullt dhe e trajtojmë edhe këtë pikë domethënë në seancë të rregullt. Nuk është diçka e jashtëzakonshme që të konsiderojmë të mbajmë mbledhje të jashtëzakonshme. Pra, propozimi im është që kjo pikë të bartet në seancën e rregullt dhe të trajtohet me pikat tjera që i kemi në seancën e rregullt.

**Antigona Bytyqi:** Faleminderit Karanfil. Po urdhëro Naxhije.

**Naxhije Memaj:** Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë. Edhe unë si kolegu kam dilemat e mia pse me kaq nguti ka ardhë kjo mbledhje e jashtëzakonshme! Nëse s'ka naj afat kohorë ka mujt me ardhë në mbledhjen e rregullt e cila për pak ditë do të mbahet. Përndryshe kjo është procedurë standarte, na e kuptojmë atë edhe si e tillë ajo duhet ti përcjellat kuvendit. Por ka mujt shumë lehtë me shku në kuvend me mbledhjen e rregullt. Kaq.

**Antigona Bytyqi:** Faleminderit Naxhije. Urdhëro Bajram.

**Bajram Kastrati:** Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë. Edhe unë pajtohem plotësisht me kolegët nëse veç kemi të drejtë që këtë pikë të rendit të ditës ta bartim në seancën e rregullt nëse kemi të drejtë ligjore edhe unë pajtohem plotësisht. S'kemi nevojë përderisa e kemi brenda javës, s'kemi nevojë t'i mbajmë dy seanca, t'i thirrur kuvendarët për këtë. Faleminderit.

**Antigona Bytyqi:** Faleminderit Bajram. Dikush tjetër? Po urdhëro Nënkryetar.

**Kujtim Gashi:** Përshëndetje anëtarë të Komitetit, faleminderit Kryesuese, fillimisht po ju përshëndes të gjithëve. Po mendoj që janë dy çështje krejt qshjte krejt që dallojnë njëra prej tjetrës. Kur mbledhja thirret prej Kryetarit të Komunës, nuk po besoj që Komiteti ka autoritet mi anul, mi shty ose me i bashku mbledhjet që janë të ndame. Mbledhja e thirrur prej anës së Kryetarit të Komunës si kategori ligjore edhe është e karakterit s'po them të jashtëzakonshëm por urgjent po sepse zakonisht bartja e mjeteve ka ndodhë kryesisht në muajin mars viteve të kalume. Por për shkak të disa procedurave që kanë ndërru në Ministri të Financave është dashtë një komunikim i vazhdueshëm dhe intenziv që e ka bë Drejtorja e Financave, ku një prej takimeve kam qenë edhe unë. Nuk e kuptoj pse duhet me shty një pikë e cila për nga natyra i takon karakterit urgjent, për faktin se pas mbledhjes që do të mbahet nesër, merrë edhe një kohë derisa këto mjete të barten në buxhetin e këtij viti. Çdo vonesë edhe ditore është e tepërt për shkak se me këtë bartje janë paraparë nja katër projekte që janë shumë të rëndësishme për qytetarët e Komunës së Prizrenit, ku njëra prej

tyre është çështja e pagesës së tokës për varrezat e qytetit. Një procedurë që tashmë ka përfunduar me një shumë të mjeteve të cilat duhet të ju paguhet AKP-së. E dini që kanë kaluar edhe procedurat e shpronësimit edhe faktura e kësaj parcele tashmë ka ardhë, çdo vonesë natyrisht na shkakton telashe neve si institucion. Nuk po e kuptoj pse duhet me u shty një pikë që është e veçantë, është shumë rëndësishme për secilin anëtar të kuvendit tuj e pasë parasyshtë mjetet ku do të barten në këto projekte. Pjesë e bartjes së këtyre mjeteve është edhe objekti i Lirisë i cili do të shpronësohet, edhe disa projekte të cilat nuk kanë pasur mjete të mjaftueshme buxhetore për realizim, siç është projekti i sheshit Shadërvan. Edhe po mendoj që nuk duhet me e shty për një mbledhje e cila është mbledhje e rregullt e thirrur prej juve, prej kuvendit, prej Kryesueses bashkë me shefat. Kjo çështje është thirrë prej kryetarit të komunës për procedu si procedurë edhe me shku në ministri edhe me bë bartja e mjeteve e cila po them edhe njëherë mund të shkon ndoshta edhe dy javë apo tre javë. Këto faktura që kanë ardhë për shpronësim nuk kanë shumë për me pritë sepse AKP-ja, natyrisht i kërkon mjetet pas shpronësimit për me bë bartjen e tokës. E dini që varrezat e qytetit janë stërmbushur edhe varrosen njëri mbi tjetrin, kurse ne kemi lluks me kërku me u shty kan 1 apo dy javë, që po mendoj nuk përkon me një realitet me të cilin jemi duket jetuar bashkërisht.

**Antigona Bytyqi:** Faleminderit Nënkryetar. Veç deshta me thënë që edhe unë po pajtohem plotësisht për shkak se në qoftëse e presim mbledhjen e rregullt neve po na merrë edhe disa ditë kohë derisa po i bëjmë përkthimet e tjera, derisa po e qojmë në ministri. Pastaj edhe ministria siç e dini pothuajse çdo vendim po na e kthejnë me shumë vonesë, jo me vonesë por me shumë vonesë! Kështu që, ndoshta duhet me na kalu mandej edhe muaji maj derisa të përfundoj. Por, gjithsesi e vendosim bashkërisht. Dafina e ka fjalën.

**Kujtim Gashi:** Edhe po du me thënë që thirrja e një mbledhjes së jashtëzakonshme është kategori ligjore, nuk ka të bëjë me mbledhjen tjetër të rregullt, domethënë e ka paraparë ligji edhe të jashtëzakonshmen. Kryetari mundet me thirrë shpesh, mundeni me thirrë edhe ju, nuk e di pse duhet me pasë pengesa në këtë drejtim!

**Dafina Alishani:** Pikësëpari ju e përmendët që KPF-ja nuk ka të drejtë me pasë naj rekomandim! Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, e thorrë shumë qartë që Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave duket përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, Rregulloret vjetore të tatimit, tarifrat dhe pagesat, planit vjetor të punës për auditim të brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim i buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në kuvendin e komunës. Domethënë na kemi të drejtë me bë rekomandime.

**Kujtim Gashi:** S'je në temë hiç!

**Dafina Alishani:** Jo, jam në temë shumë se ti po thu që KPF-ja...

**Kujtim Gashi:** Se thashë, asgjë se pata në lidhje me këtë. Thashë s'ki të drejtë me shty ose me fuzionu një pikë që e ka kërku kryetari, mos dil prej temës.

**Dafina Alishani:** Ti po thu që KPF-ja nuk ka të drejtë me marrë ndonjë vendim lidhur me kuvendin se çka me bo e çka mos me bo.

**Kujtim Gashi:** Me këtë pikë që e ka thirrë kryetari ti s' mundesh me shty, ti mundesh me votu ose mos me votu, dy sene janë.

**Dafina Alishani;** Nëse ka implikime buxhetore është komplet përgjegjësi e KPF-së e para. E dyta, nëse qaq i paska punët për ngutë edhe qaq qenkan punët shumë me rëndësi, ai zotnia su dashtë me shku nëpër Amerikë nëpër erskurziona. Është dashtë me ndejt këtu edhe me qeto çështjet që i paska me rëndësi edhe mi shty përpara.

**Kujtim Gashi:** E ka ai zëvendësin.

**Dafina Alishani:** Arsyetimet që po i bëni është e kotë, kur ju konvenon. E keni ju një nguti tjetër këtu por s'jeni të sigurtë me na tregu. Edhe pse bre me e ngarku palidhje kur ashtu, ashtu edhe kuvendin nuk e kemi të ngarkuar! Janë çështje të cilat një rend, një pikë e keni edhe çështjet buxhetore sot një javë bre ke me pasë prap mbledhje.

**Kujtim Gashi:** Ku është problemi që mos me u mbajtë seancë?

**Dafina Alishani:** Problemi është tek kryeneqësia e kryetarit që nuk vjen...

**Kujtim Gashi:** Domethënë ju paskit paragjykime kështu me inati këtë çështje. Në rregull veç arsyetonu para kamerave

**Dafina Alishani;** Jo paragjykim nuk është, s'kam çka mu arsyetu para kamerave sepse kurgjo s'jam tuj mshefë.

**Kujtim Gashi:** Kurqysh s'je tuj e arsyetu.

**Dafina Alishani:** Por s'po ju konvenon o Kujtim.

**Kujtim Gashi:** Po më vjen keq.

**Dafina Alishani:** Edhe pyetja tjetër, qysh ka mundësi me pas qaq mungesë të planifiimit, diku 2 milion euro po ju dalin tash të paplanifikume! Ju a ishit një qeverisje që e kishit edhe buxhetin të kompletum edhe kërkesat e kompletume edhe krejt. Ju qeshtu thojshit! Na jena menaxhera të mirë.

**Sulltan Badalli:** Është normale ajo, sepse janë projekte tre vjeçare.

**Dafina Alishani:** Nuk është normale me të dal 2 milion të paplanifikum edhe tash me pa ku me marrë edhe ku mos me marrë. Nuk ka kurgjo të keqe nëse shtyhet për shkak se është mbledhja e rregullt. Mos të ish kanë mbledhja e rregullt.

**Kujtim Gashi (Nënkryetari i Komunës):** Mbledhjen e jashtëzakonshme s' mundesh me shty, a po e sheh që s'po e din!

**Dafina Alishani:** Jo, jo, rekomandimin ti mundesh me ja bë.

**Kujtim Gashi:** Rekomandimin ja bënë mbledhjes së rregullt, a po e sheh që s'po e din, rekomandimin e bë mbledhjes së rregullt e jo të jashtëzakonshme.

**Dafina Alishani:** Jo, ja bënë edhe të jashtëzakonshmes.

**Kujtim Gashi:** Ai e cakton rendin e ditës edhe....

**Dafina Alishani:** Por s'është më së pari çështje e jashtëzakonshme.

**Kujtim Gashi:** Na e kemi konsideru që është e jashtëzakonshme.

**Dafina Alishani:** Epo qysh doni ju për qejfi me e konsideru por nuk është.

**Kujtim Gashi:** Na e kemi konsideru se ti kur kemi na nganjëherë kështu na debat me qeverinë e mbronë qeverinë, kur të koordinohemi me qeverinë sikur në këtë rast domethënë del kundër.

**Dafina Alishani;** çka po koordinoheni me qeverinë? Ku kam unë një koordinim, unë ma nuk ju besoj. A e din pse?

**Kujtim Gashi:** Për neve pak ka rëndësi a na beson ti, për neve kanë rëndësi veç ata që na kanë dhënë votën.

**Dafina Alishani:** Jo sepse dilni pa fijen e marres na gënjeni edhe kurgjo s'ndodh, thuni bajmë investime me leje, nuk keni leje, plot plot rrena që i kena ni.

**Kujtim Gashi:** S'je në temë sinqerisht, s'ja vlenë as me diskutu.

**Dafina Alishani;** Jam, jam. A tash unë nëse ti po thu me ministrinë paske komunikim, pse s'na ke pru komunikimin me ministrinë? Unë ma nuk ju besoj.

**Kujtim Gashi:** Tash ta bi edhe të kallxoj edhe në takime se çka kemi folë, Sulltan dërgoja foto.

**Antigona Bytyqi:** Ju lutem qëndroni në temë.

**Dafina Alishani:** Qe në rend të ditës jena.

**Sulltan Badalli:** çka ka rëndësi komunikimin e ministrisë me ja u pru juve këtu.

**Dafina Alishani;** Qysh çka ka?

**Sulltan Badalli:** Drejtoria e Financave e ka kontaktin me ministrinë edhe kemi ardhë në përfundim që me e kry këtë procedurë.

**Dafina Alishani;** Unë ma nuk po ju besoj, saherë keni ardhë këtu keni thënë na ka rekomandu ministria edhe ka dalë që s'është e vërtetë.

**Sulltan Badalli:** Po shumë e vërtetë është.

**Dafina Alishani:** çka të keni komunikime me shkrim apo me çka ju ka kërkuar ministria na bjeni.

**Sulltan Badalli:** Jo komunikime me shkrim por direkt kemi qenë kështu në takim.

**Dafina Alishani;** Në rregull o.

**Antigona Bytyqi:** Bajrami fjalën.

**Bajram Kastrati:** Faleminderit Kryesuese. Unë po supozoj që nëse nuk e miratojmë këtë rekomandim, a do të mbahet seanca?

**Kujtim Gashi:** Po, po, patjetër, seancën e ka thirrë Kryetari i Komunës.

**Bajram Kastrati:** E nëse s'ka kuorum për shqyrtim në seancë.

**Karanfil Haxhillari:** Kujtim thuaje të vërtetën. Në qoftëse KPF-ja, nuk e shtyen, nuk kët1% pikë të rendit të ditës seanca nuk mbahet sepse është e jashtligjshme. Sepse Ligji thotë të gjitha dokumentet që kanë përfshirje buxhetore.

**Kujtim Gashi:** Jo jo, katastrofë je tuj fol, po më vjen keq, 4 vjet ke qeverisë e s'po e din qysh mbahet seanca, përnime je tuj mu dhimtë.

**Karanfil Haxhillari:** Hajde po e kqyrim, po e shohim.

**Bajram Kastrati:** Po mirë, nëse edhe mbahet seanca, unë tash s'po du me hy me politizu këtë çështje. Na e kemi ndërmjet 1 javë, Nënkyetar i argumentove ti disa pika që edhe unë pajtohem plotësisht, sidomos për projektin e varrezave e kemi diskutuar 100 herë edhe vonë është që edhe 1 javë me shty, kjo është shty e është stërzgjatë. Mua po më duket e panevojshme diskutimi, nëse kemi hapësirë ligjore me shty për 1 javë në seancën e radhës që s'kemi shumë pika, pse me i mbledh na edhe njëherë kuvendarët brenda javës.

**Kujtim Gashi:** Qatë punë e kanë kuvendarët.

**Bajram Kastrati:** Po qat punë e kanë por na s'kemi shumë pika. Ok, ta kishim pasur të ngarkume seancën e radhës ok.

**Kujtim Gashi:** Tash i bjen që ti me qytetarët je tuj u tallë.

**Karanfil Haxhillari;** Tallje është me kuvendarët kjo.

**Kujtim Gashi:** Që i shtyen 4 pika, 4 projekte dhe thotë edhe 1 javë! Pse edhe 1 javë? Këto edhe 1 orë nuk presin o zotni sepse kanë mbetë njerëzit pa u varrosë, 4 vjet1% s;keni ba kurgjo për varrezat, tash njëjtë jeni tuj ba edhe sot!

**Karanfil Haxhillari:** Shiko, vetë titulli zotni po thotë: bartja e mjeteve nga të hyrat të rritura nga ato të planifikuara në vitin 2023! Tash jemi në fund të prillit 2024 dhe urgjenc keni ju?

**Kujtim Gashi:** Po.

**Karanfil Haxhillari:** Urgjencë ku të planifikimet e 2023-tës, 1 vjet e gjysmë po vonohen.

**Kujtim Gashi:** Kemi urgjencë sepse ne jemi të përgjegjshëm para qytetarëve.

**Karanfil Haxhillari:** Po shihet.

**Kujtim Gashi:** S'po shihet tek ti.

**Karanfil Haxhillari:** Një, e dyta domethënë të planifikuara në vitin 2023 dhe me urgjencë për 1 javë po ju doket urgjencë!

**Kujtim Gashi:** Edhe 1 orë është shumë.

**Karanfil Haxhillari:** Kjo është tallje me qytetarët por edhe me kuvendarët. Ne shumë mirë deshtëm mirëkuptim që kjo pikë të trajtohet në seancë të rregullt ku edhe e kish pasur mbështetjen normal edhe të kuvendarëve. Ju, në qoftëse me këtë injorancë të cilën po e krijoni vetë, me këtë arrogancë të cilën poashtu po e krijoni vetë, mos e fajësoni nesër opozitën kur nuk vijmë në mbledhje në seancë.

**Kujtim Gashi:** Se kemi atë gajle ndaqe me ditë hiç.

**Karanfil Haxhillari:** Na kërkohet që kjo pikë e rendit të ditës me kalu në seancën e rregullt sepse nuk ka as afate.

**Kujtim Gashi:** Pse se ke kërkim kur jeni konsultu për me thirrë seancën, pse se ke lypë aty kur jeni konsultu për rendin e ditës.

**Karanfil Haxhillari:** S'jemi konsultu.

**Bajram Kastrati:** S'jemi konsultu.

**Antigona Bytyqi:** Jo, këtë mbledhje s'jemi konsultu sepse kanë thënë që nuk është e nevojshme.

**Kujtim Gashi:** Karanfil Mos i përziej, mos i ngatërroni senet. Këtë e ka thirrë Kryetari i Komunës për një çështje të caktuar, doni me mbështetë mirë, nuk doni, kaq.

**Dafina Alishani:** A po e nin Kryesues se çka po thotë.

**Antigona Bytyqi:** Ndëgjo, Nënkrjetari e din që zakonisht mblidhemi, por këtë mbledhjen e fundit ka qenë një pajtueshmëri që më kanë thënë i diskutojmë pikat e rendit të ditës në KPF. Kështu që në rregull jemi.

**Karanfil Haxhillari:** Mirë ashtu është, në rregull jemi.

**Levet Bus:** Mirë de, por që bëjmë nesër mbledhje çka bëhet?

**Karanfil Haxhillari:** Kjo është me të vërtetë e pakuptimtë, kjo është komplet e pakuptimtë!

**Antigona Bytyqi:** Pse Karanfil e pakuptimtë kur ligji e lejon edhe seancat e jashtëzakonshme.

**Karanfil Haxhillari:** Hajde bre po mbajmë çdo ditë pra.

**Bajram Kastrati:** Po bre e kishim mbajtur këtë seancë pa problem, edhe nesër e kishim mbajtur. Por, përderisa e kemi seancën shumë afër për qeta. Unë s'po du me hy me politizu keni ba, s'keni ba edhe spo du për inati me kundërshtu në atë kuptimin politik. Pse përderisa e kemi afër, pse s'po koordinohem dhe mu pajtu, se di!pasi kemi të drejtë ligjore.

**Kujtim Gashi:** S'kemi kohë o Bajram, saher kemi diskutu çshtjen e varrezave.

**Bajram Kastrati:** Unë nja 5, 6 herë e kam diskutu çshtjen e varrezave, saqë jam ba bajat, keshnin edhe kolegët. Për çshtjen e varrezave e di që është urgjente, ama koka shty kaq shumë, për 1 javë është në pyetje.

**Kujtim Gashi:** Shumë është edhe 1 javë sepse edhe 3 javë tjera vonohet. Faturën e ka në zyre kryetari për varrezat.

**Bajram Kastrati:** Po bre na jemi për, sa i përket projektit është gjithqka ok. Unë s'jam tuj kundërshtu edhe bartjen edhe, gjithqka është ok, është në pyetje disa ditore, pse me çdo kusht me?

**Kujtim Gashi:** Po ku është përgjegjësia, çfare punë ka kuvendari? Nuk është bash qashtu qysh po thoni ju.

**Bajram Kastrati:** Jo unë s'po e kam shumë të qartë vallahi, edhe thirrjen maspari s'po e kam shumë të qartë përderisa kemi pas afate ligjore, edhe thirrjen përderisa kemi pas me thirrë mbledhjen, pse është bë kjo thirrje?

**Kujtim Gashi:** Na e kemi thirrë para juve mbledhjen.

**Antigona Bytyqi:** Po mbledhja është thirrë.

**Bajram Kastrati:** Po mirë, a jeni kanë në koordinim me Kryesuesen, keni mujtë me Kryesuesen.

**Karanfil Haxhillari:** Po jo more çfarë koordinim, se me pas ditë e kishin qitë në të rregullt, po leje.



**Kujtim Gashi (Nënkryetari i Komunës):** Koordinimi është, përditë pijmë kafe.

**Antigona Bytyqi:** Koordinimi është.

**Dafina Alishani:** A keni nijet pra me e respektu kuvendin si organ ligjvënës?

**Kujtim Gashi (Nënkryetari i Komunës):** Po a keni nijet ju me e respektue Kryetarin e Komunës? Asnjëherë hiç!

**Dafina Alishani:** Unë ju respektoj kur ju neve a po na respektoni.

**Kujtim Gashi (Nënkryetari i Komunës):** Asnjëherë hiç, respekti është reciprok.

**Dafina Alishani:** Reciprok është por ju duheni, na jena organi ma i lartë.

**Kujtim Gashi (Nënkryetari i Komunës):** Mbi të gjitha ti mos e respekto komunën, as Kryetarin e Komunës, veç respektoji qytetarët, ki përgjegjësi.

**Dafina Alishani:** Ti je institucion, edhe ti ke përgjegjësi.

**Kujtim Gashi (Nënkryetari i Komunës):** Për qeta po veprojmë.

**Dafina Alishani:** Këqyre, Kuvendi është organi ma i lartë. Nëse ju nuk koordinoheni me Kryesuesen, nuk koordinoheni me KPF-në, unë se di me kënd po koordinoheni.

**Kujtim Gashi (Nënkryetari i Komunës):** Jo, na koordinohemi, por na e shfrytëzojmë një të drejtë ligjore të cilën ti po e kundërshton.

**Dafina Alishani;** Edhe na po e shfrytëzojmë të drejtën ligjore edhe po thojmë që nuk është në rregull kjo. Mungesë të planifikimit ke qe 4 muaj...

**Kujtim Gashi (Nënkryetari i Komunës):** Shfrytëzoje, qe ku e ke kamerën edhe unë e di çka them pastaj pas teje.

**Dafina Alishani:** Unë se kam brengën para kamerave.

**Kujtim Gashi (Nënkryetari i Komunës):** Në rregull jemi.

**Karanfil Haxhillari:** Sa i përket, qe para kamerave. Sa i përket të drejtave ligjore që po i përmend Nënkryetari në këtë rast, edhe neve i kemi kërkuar do të drejta ligjore të cilat ky Nënkryetar së bashku me partinë e vetë i kanë bojkotuar në tansi. Rasti është për faljen e tatimit në pronë nën 100 euro dhe e patën bojkotu seancën dhe nuk patën ardhë dhe patën dalë subficit plus 7 milion euro.

**Kujtim Gashi (Nënkryetari i Komunës):** Kamufllazhë janë këto o Karanfil.

**Karanfil Haxhillari:** Po, po, kemi kërku seancë të jashtëzakonshme për faljen e tatimit në pronë, nuk po dojmë na për hakmarrje. Në këtë rast kërkuam që nuk është situatë e jashtëzakonshme, nuk është rast i jashtëzakonshëm që të kemi seancë të jashtëzakonshme, edhe kërkojmë që kjo pikë e rendit të ditës të diskutohet në seancën e rregullt që është javën e ardhshme. Qekaq e thjeshtë është se tash, besoj që duhet me qitë në votim a din u.

**Bajram Kastrati:** A lejohet qekjo mu bartë?

**Kujtim Gashi (Nënkryetari i Komunës):** Jo, jo.

**Bajram Kastrati:** Pse s'lejohet?

**Levent Bus:** Sahere e ke përmend varrezat, varrezat.

**Bajram Kastrati:** Po unë e kam përmend shumë herë, unë thash s'jemi kundër projektit, ama s'do të thotë tash mrena ditës me, se u politizu shumëçka.

**Antigona Bytyqi:** Nëse nuk keni diçka tjetër po e hedhim në votim.

**Bajram Kastrati:** Jo, unë personalisht e lëshoj mbledhjen se është tuj u politizu shumëçka edhe.

**Karanfil Haxhillari:** E lëshojmë edhe ne mbledhjen, me arrogancë nuk bëhen gjërat, kërkuam mirëkuptim.

**Kujtim Gashi (Nënkryetari i Komunës):** Ti qeshtu ke ba edhe te Mytaher Haskuka, përgjegjësia e jote ndaj qytetarëve është nul. Për qeta jeni ndëshku edhe keni me u ndëshku gjatë.

**Karanfil Haxhillari:** Po po, do të shihet.

**Antigona Bytyqi:** Shkojmë 5 minuta pauzë, pastaj vazhdojmë.

Pas Pauzës

**Antigona Bytyqi:** Të nderuar anëtarë, nëse nuk keni edhe diçka me shtu rreth kësaj pike po e hedhim në votim që ti rekomandohet mbledhjes së nesërme. Prezent jemi 5 anëtarë, kush është për? Unanimisht, ju faleminderit shumë. Ju falënderoj për prezencën e juaj dhe shihemi nesër në mbledhjen e jashtëzakonshme.

**Kryesuesja e Kuvendit  
Antigona Bytyqi**

